



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 154
Datë: 3 / 2 / 2022

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", mbështetur në nenet 17 dhe 23 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 13.1.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Studentët e nivelit të doktoratës, të cilëve u është zgjatur periudha e studimit për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të tyre, si vonesat në caktimin e mentorimit, realizimin e punës hulumtuese ose publikimin e rezultateve të punës hulumtuese, ratifikimin e temës etj., lirohen nga pagesa e semestrave më së shumti për një vit akademik (dy semestra), sipas kushteve në vijim:
 1. Studentët të cilët nuk e kanë kryer pagesën e dy semestrave të vitit akademik 2020/21, lirohen nga obligimi i pagesës për vitin akademik 2020/21, ndërsa obligohen që të kryejnë pagesën për vitin akademik 2021/22 e tutje, deri në diplomim.
 2. Studentët të cilët kanë kryer pagesën vetëm për njërin semestër të vitit akademik 2020/21, lirohen nga obligimi i pagesës të semestrit të mbetur të vitit akademik 2020/21 dhe njërit semestër të vitit akademik 2021/22.
 3. Studentët të cilët i kanë kryer të gjitha pagesat deri në vitin akademik 2020/21, lirohen nga obligimi i pagesës së semestrave të vitit akademik 2021/22.
- II. Lirimi nga pagesa e semestrave vlen për studentët në periudhë aktive të studimit dhe nuk nënkupton rimbursim rektroaktiv të studentëve të cilët i kanë përfunduar studimet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- III. Vendimi për lirimin nga pagesa të studentëve sipas këtij vendimi, merret nga dekani i njësisë përkatëse akademike mbi bazën e kërkesës së argumentuar të studentit ose grupit të studentëve.
- IV. Lirimi nga pagesa e kategorisë së studentëve sipas këtij vendimi, nuk nënkupton rimbursimin e pagesave për studentët që i kanë kryer obligimet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi
- V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Këshillin Drejtues.

A r s y e t i m

Me hyrjen në fuqi të UA (MASHT) nr. 09/2021, për aplikimin e pagesave të studentëve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, studentët e nivelit të doktoratës i kanë parashtruar kërkesa dhe ankesa njësisive përkatëse akademike dhe Këshillit Drejtues të UP-së. Studentët, ankesat e parashtruara i kanë arsyetuar me pamundësinë për t'i përfunduar studimet, për shkak të vonesave

në caktimin e mentorimeve, vështirësive për komunikim dhe takime këshilluese me mentorë dhe situatave të tjera jashtë kontrollit të studentëve, si pamundësisë së realizimit dhe publikimit të rezultateve të punës hulumtuese, të shkaktuara kryesisht gjatë dy viteve të fundit si pasojë e situatës me pandeminë. Këshilli Drejtues i UP-së, vendosi që ta lejojë lirin nga pagesa të studentëve të nvielit të doktoratës për më së shumti dy semestra gjatë periudhës së studimit, mbështetur në arsyeshmërinë dhe argumentet e kërkesave të studentëve, të cilat do t'i shqyrtojnë dhe do t'i miratojnë dekanët e njësive akademike.

Mbështetur në atë çfarë u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Menaxhmentit të UP-së,
3. Dekanëve të njësive akademike,
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
5. Sekretarëve të njësive akademike,
6. Shërbimit të financave të UP-së.



Këshilli/Drejtues i UP-së

Dr. Arbëresha Nela - Turjaka, kryesuese